



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ

Raporti i rregullt i punës
GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Janar-mars 2024

RAPORTI I RREGULLT I PUNËS SË GJYKATËS THEMELORE NË FERIZAJ
(Periudha 1 janar deri me 31 mars 2024)

Bazuar në nenin 14 paragrafi 2 pika 2.5 të Ligjit për Gjykatat, Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, paraqet raportin e rregullt të punës për periudhën 1 janar - 31 mars 2024.

Gjykata Themelore në Ferizaj së bashku me degët e sajë në Kaçanik dhe Shtërpcë përmes këtij raporti prezanton në mënyrë përmbledhëse në formë statistikore dhe tabelore punën e sajë gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, duke prezantuar njëkohësisht të arriturat dhe sfidat gjatë kësaj periudhe raportuese, si në aspektin profesional po ashtu edhe në atë administrativ.

Aktualisht Gjykata Themelore në Ferizaj me degët e saja në Kaçanik dhe Shtërpcë ka të angazhuar gjithsejtë tridhjetë e një (31) gjyqtar duke përfshirë edhe kryetarin e gjykatës, ku tre prej tyre gjyqtar janë të emëruar në janar të këtij viti, dhe aktualisht janë duke e ndjekur trajnimin fillestar për gjyqtar në Akademinë e Drejtësisë. Ndërsa numri total i të punësuarve në Administratën e Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe degët e sajë në Kaçanik dhe Shtërpcë është 124 persona të punësuar përfshirë Administratorin e gjykatës dhe dy ndihmës administrator.

Në aspektin financiar, gjatë periudhës raportuese, ekipi financiar ka qenë i konsoliduar dhe ka arritur ti përfundoj me sukses detyrat që kanë të bëjnë me çështjet financiare. Në këtë periudhë raportuese (janar-mars 2024), zyra e financave ka realizuar: të hyra gjyqësore të cilat janë derdhur në Buxhetin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës e që kanë qenë 263,012.16 €, prej tyre 170,985.00 € janë të hyra nga gjobat dhe 92,027.16 € pagesa nga taksat dhe paushallët gjyqësore, ndërsa shpenzime buxhetore për nevojat e gjykatës gjatë këtij tremujori kanë qenë 39,816.17 €, prej tyre 31,080.21 € janë shpenzuar për mallra dhe shërbime, ndërsa 8,735.96 € për shpenzime komunale.

Gjykata për periudhën raportuese, në kuadër të Udhëzimit Administrativ (02/2016) për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjykimeve, ka vazhduar publikimin e aktgjykimeve të anonimizuara dhe për këtë periudhë janë publikuar rreth 968 aktgjykime.

Web Portali i gjyqësorit edhe për këtë periudhë ka shërbyer si urë lidhëse ndërmjet publikut dhe gjykatës kjo me qëllim të informimit të publikut rreth aktiviteteve, orarit të seancave gjyqësore, vendimeve dhe të tjera, ndërsa përmes rrjetit social facebook publikut i është mundësuar qasje më e lehtë në punën e gjykatës. Përveç këtyre shërbimeve të cilat ofrohen në portalin gjyqësor dhe rrjetet sociale, si shërbime shtesë të cilat dëshmojnë transparencën e gjyqësorit karshi publikut, në hyrje të gjykatës janë të vendosur tre monitorë të cilët pasqyrojnë kalendarin me orarin e seancave gjyqësore si dhe tabela orientuese, këto si në Gjykatën Themelore në Ferizaj ashtu edhe në degët e sajë në Kaçanik dhe Shtërpcë.

Gjithashtu Gjykata Themelore Ferizaj e përkrahur nga USAID- Projekti për Drejtësi është duke vazhduar Projektin për Drejtësi Procedurale që ka për qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qasje në shërbimet të cilat ofrohen nga gjykata.

Gjykata Themelore në Ferizaj gjatë kësaj periudhe ka vazhduar bashkëpunimin me institucione, veprimtaria e të cilave mundë të ketë ndikim në aspektin e efikasitetit apo të ngritjes së besueshmërisë së opinionin publik përgjithësi në gjykatë ka vazhduar të shfaqë efekte pozitive si në zbatimin e urdhëresave të lëshuara nga gjykata, ashtu edhe me zbatimin e vendimeve nga ana e institucioneve si nga ana e Policisë së Kosovës, Prokurorisë Themelore Ferizaj. Bashkëpunimi me Prokurorinë Themelore në Ferizaj është i vazhdueshëm, po aq sa edhe me Policinë Rajonale të Ferizajt.

Gjatë kësaj periudhe raportuese bazuar në raportet statistikore të gjykatës dhe analizimit të tyre, bazuar edhe në Planin vjetor të punës së gjykatës por edhe bazuar në planin strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi, Kryetari i Gjykatës pas konsultimit edhe me udhëheqësit e departamenteve të kësaj gjykate muajit shkurt të vitit 2024, ka hartuar planin e rishpërndarjes së lëndëve në Gjykatën Themelore në Gjykatën Themelore në Ferizaj me G.J.A.nr.96/24 të datës 28.02.2024, i cili plan ka për qëllim zvogëlimin e lëndëve përkatësisht rritjen e efikasitetit në trajtimin dhe zgjidhjen e lëndëve në divizionin kundërvajtës dhe atë civil. Me këtë plan të

rishpërndarjes së lëndëve përkohësisht është planifikuar që tre (3) gjyqtarë të Departamentit të Përgjithshëm-Divizionit Penal, përveç lëndëve penale që kanë në punë të angazhohen dhe të ngarkohen edhe me lëndë të Divizionit Civil konkretisht me Padi të kontratave Kolektive, të cilat planifikohen do të përfundohen në gjashtë mujorin e parë të këtij viti, ndërsa dy (2) gjyqtarë të Departamentit të Përgjithshëm-Divizionit Penal përveç lëndëve penale që kanë në punë të angazhohen dhe të ngarkohen edhe me lëndë të divizionit kundërvajtës, krejt kjo me qëllim të zgjidhjes së lëndëve në kohë pasi që siç dihet afati i parashkrimit të tyre është mjaft i shkurt. Ndërsa katër gjyqtarët e Departamentit për Krime të Rënda për një periudhë gjashtë mujore do të punojnë edhe lëndë të departamentit të përgjithshëm – divizionit penal.

Statistikat

Gjatë periudhës raportuese gjykata ka të evidentuara në punë 28258 lëndë (pa përfshirë lëndët kundërvajtëse) në Departamentin për Krime të Rënda, në Departamentin e Përgjithshëm, Divizioni Penal dhe Civil, janë përfunduar 3805 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 24453 lëndë.

Departamenti për Krime të Rënda gjatë periudhës raportuese ka pranuar 15 lëndë, ka përfunduar 36 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 127. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë në DKR është 240.00%.

Departamenti për të Mitur në periudhën raportuese ka pranuar 31 lëndë, ka përfunduar 29 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 40 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë është 94 %.

Në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Penal (së bashku me degë), pa përfshirë procedurën paraprake në periudhën raportuese ka pranuar gjithsej 358 lëndë, ka përfunduar gjithsej 482 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 2448 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë është 134.64 %.

Në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil (së bashku me degë), gjatë këtij tremujori janë pranuar gjithsej 1874 lëndë, ka përfunduar 1464 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 9764. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë është 78.12 %. Kjo përqindje e ulët e normës së spastrimit është si rezultat vazhdimit të ardhjes së numrit të madhe të padive civile, konkretisht

lëndëve që kanë të bëjnë me kontratat kolektive të punonjësve të arsimit, shëndetësisë dhe policisë, dhe nga ky Departament një gjyqtarë nga gjykata Themelore arritur moshën e pensionimit, ndërsa një gjyqtar i cili është në trajnim fillestar për gjyqtar në Akademinë e Drejtësisë deri në fund të Prillit 2024 është ngarkuar me të gjitha lëndët që ka pasur në punë gjyqtari i pensionuar dhe të gjitha këto kanë ndikuar që ky departament për këtë periudhë raportuese të ketë këtë përqindje të numrit të zgjidhjes së lëndëve.

Në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Kundërvajtës (së bashku me degë) gjatë këtij tremujori ka pranuar gjithsej 842 lëndë, ka përfunduar 722 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 3881 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë është 85.75 %.

Sfidat

Gjatë kësaj periudhe raportuese Gjykata Themelore në Ferizaj dhe degët e saj ka vazhduar të përballet me numër të madhe të lëndëve civile në ardhje, të cilat janë kryesisht lëndët që kanë të bëjnë me kontrata kolektive të punëtorëve të shëndetësisë, arsimit e policisë.

Po ashtu duke pasur parasysh edhe pamundësinë e plotësimit të pozitave të lira dhe shpalljen e konkurseve nga SKGJK, gjykata jonë dhe dega e Kaçanikut ka një numër të madhe të pozitave të lira e të pa plotësuara e të cilat po ndikojnë në përmbushjen e detyrave dhe efikasitetin e gjykatës në përgjithësi.

Gjatë kësaj periudhe në degën e gjykatës në Kaçanik, siç jeni në dijeni ka ndodhur një zjarrëvenie e qëllimshme nga persona tani për tani të dyshuar dhe të arrestuar dhe si pasojë e këtij zjarri janë dëmtuar shumë rëndë një pjesë e gjykatës konkretisht dy zyra të gjyqtarëve të cilët punojnë në lëmine penale, është dëmtuar komplet inventari i zyrave të këtyre dy gjyqtarëve dhe janë djegur dhe dëmtuar edhe dosjet penale dhe atë në zyrën e gjyqtarës Zajrete Muhaxheri për fat të mirë dosjet penale kanë shpëtuar të gjitha përveç njëres e cila është djegur nga zjarri, ndërsa në zyrën e gjyqtarit Burim Çaka janë dëmtuar dhe djegur dosjet që ka pasur në zyrë ku nga ana e komisionit të themeluar nga Kryetari i Gjykatës është konstatuar se janë djegur 224 lëndë penale dhe 268 lëndë të procedurës kundërvajtëse. Të gjitha lëndët janë në procedurë të ripërtrirjes së tyre sepse kanë qenë të regjistruara në sistemin SMIL. Po ashtu edhe punimet në renovimin e pjesës së dëmtuar të gjykatës kanë filluar dhe pritet së shpejti të përfundohen dhe dega e gjykatës të kthehet në funksion të plotë.

Gjykata Themelore në Ferizaj me Degë

Në vazhdim tabela 1 përmban të dhënat për lëndët e trashëguara, të pranuar, në punë, të kryera dhe lëndët e pa kryera për tremujorin e parë të vitit 2024 (1 janar deri më 31 mars 2024) për Gjykatën Themelore në Ferizaj me degë

Lloji i lëndëve	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuar-2024	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Procedura Paraprake - DP	209	41	250	123	127
Penale shkalla e parë- DP	2572	358	2930	482	2448
Procedurë Paraprake - DKR	50	22	72	72	0
Penale shkalla e parë - DKR	148	15	163	36	127
Penale për të mitur në proc.përgaditore	5	3	8	8	0
Penale për të mitur në proc.Para Kolegjit	38	31	69	29	40
Civile të shkallës së I-rë	9354	1874	11228	1464	9764
Jashtëkontestimore	503	87	590	94	496
Përmbarimore	4070	380	4450	430	4020
Përmbarime sipas dokumenteve autentike	1843	0	1843	129	1714
Përmbarime sipas dokumentit përmbarues	541	2	543	195	348
Ekz.Paushalla dhe shpenzime gjyqësore	3952	389	4341	335	4006
Përmbarimore PPP	409	53	462	77	385
Ekz.Penale me burg	151	39	190	54	136
Ekz. Penale me gjobë- EDGJ	901	213	1114	276	838
Ekz.i masave edukative për të mitur	4	1	5	1	4
UGJK	0	0	0	0	0
GJITHËSEJTI	24750	3508	28258	3805	24453
Lëmia Kundërvajtëse	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuar-2024	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Lëmia- Kundërvajtëse	3761	842	4603	722	3881
GJITHËSEJTI	3761	842	4603	722	3881

Në bazë të statistikave si në tabelën më lartë rezulton se Departamenti për Krime të Rënda, shprehur në përqindje ka përfunduar 240.00 % të lëndëve në raport me numrin e lëndëve të pranuar në

periudhën raportuese, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, shprehur në përqindje ka përfunduar 134.64 % të lëndëve në raport me numrin e lëndëve të pranuar në periudhën raportuese, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, shprehur në përqindje ka përfunduar 78.12 % të lëndëve në raport me numrin e lëndëve të pranuar në periudhën raportuese.

Ndërsa në total norma e spastrimit të lëndëve të pranuar në raport me lëndët e përfunduara në Gjykatën Themelore në Ferizaj së bashku me degët Kaçanik dhe Shtërpcë (pa përfshirë lëndët kundërvajtëse) është 108.47 %, megjithatë kjo shkallë e efikasitetit duhet të ngritet, andaj gjatë muajve në vijim prioritet i gjykatës do të vazhdoj të jetë përfundimi i sa më shumë lëndëve të vjetra të parapara edhe me strategjinë për reduktimin e lëndëve të vjetra si dhe përfundimi i lëndëve me natyrë korruptive.



Gjykata Themelore në Ferizaj


Për periudhën raportuese nga data 1 janar deri me 31 mars 2024, në Gjykatën Themelore në Ferizaj lëndë të pranuar në punë kanë qenë 2763 lëndë, prej tyre 627 janë nga lëmia kundërvajtëse. Lëndë të kryera në këtë periudhë janë 3172 lëndë, prej tyre të divizionit për kundërvajtje janë kryer 535 lëndë.

Për tremujorin e parë të këtij viti lëndë të raportuara si të pa kryera janë gjithsej 20,771 lëndë, nga ky numër 2860 janë lëndë të divizionit për kundërvajtje.

Në vazhdim tabela përmban të dhënat për lëndët e trashëguara, të pranuar, në punë, të kryera dhe lëndët e pa kryera për tremujorin e parë të vitit 2024 (1 janar deri më 31 mars 2024) për Gjykatën Themelore në Ferizaj.

Lloji i lëndëve	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuar-2024	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Procedura Paraprake - DP	85	26	111	108	3
Penale shkalla e parë- DP	1670	272	1942	333	1609
Procedurë Paraprake - DKR	50	22	72	72	0
Penale shkalla e parë - DKR	148	15	163	36	127
Penale për të mitur në proc.përgaditore	5	3	8	8	0
Penale për të mitur në proc.Para Kolegjit	38	31	69	29	40
Civile të shkallës së I-rë	7490	1482	8972	1277	7695
Jashtëkontestimore	246	74	320	48	272
Përmbarimore	2674	311	2985	380	2605
Përmbarime sipas dokumenteve autentike	1219	0	1219	129	1090
Përmbarime sipas dokumentit përmbarues	500	2	502	195	307
Ekz.Paushalla dhe shpenzime gjyqësore	3035	274	3309	215	3094
Përmbarimore PPP Ekz	254	44	298	68	230
Ekz.Penale me burg	120	36	156	47	109
Ekz. Penale me gjobë- EDGJ	782	170	952	226	726
Ekz.i masave edukative për të mitur	4	1	5	1	4
UGJK			0		0
GJITHËSEJT	18320	2763	21083	3172	17911
Lëmia Kundërvajtëse	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuar-2024	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Lëmia- Kundërvajtëse	2768	627	3395	535	2860
GJITHËSEJT	2768	627	3395	535	2860

Gjatë tremujorit të parë, angazhimi i gjyqtarëve me qëllim të zvogëlimit të numrit të lëndëve dhe zgjedhjes sa më shpejtë të tyre ka reflektuar pozitivisht, megjithatë duhet të theksohet fakti se Gjykata Themelore në Ferizaj vazhdon të ketë mungesë të numrit të gjyqtarëve në të gjitha departamentet. Aktualisht në Departamentin për Krime të Rënda janë të angazhuar pesë (5) gjyqtar përfshirë edhe kryetarin e gjykatës, në Departamentin për të Mitur është i angazhuar një (1) gjyqtar, në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Penal janë të angazhuar pesë (5) gjyqtar, në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil janë të angazhuar shtatë (8) gjyqtar (dy prej të cilave janë të minoritetit serbë dhe kanë vështirësi në kryerjen e punëve në gjykatë, për shkak të përkthimit, mungesës së zyrtarëve ligjor dhe stafit mbështetës serbë), njëri prej tyre është i ngarkuar për trajtimin vetëm të lëndëve përmbartimore. Ndërsa në Divizionin për Kundërvajtje janë të angazhuar dy (2) gjyqtar. Ndërsa në Gjykatën Themelore në Ferizaj- dega në Kaçanik aktualisht ka të angazhuar 4 gjyqtar duke përfshirë edhe mbikëqyrësin e degës. Ndërsa në Gjykatën Themelore në Ferizaj – dega në Shtërpcë janë të angazhuar mbikëqyrësi i degës me lëndë të natyrës civile, dhe një gjyqtare në lëmine në lëminë penale dhe kundërvajtëse.



Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik

Të dhënat për lëndët e trashëguara, të pranuar, në punë, të kryera dhe lëndët e pa kryera për tremujorin e parë të vitit 2024 (1 janar deri më 31 mars 2024) për Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik.

Lloji i lëndëve	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuar-2024	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Procedura Paraprake - DP	121	12	133	11	122
Penale shkalla e parë- DP +	792	67	859	94	765
Procedurë Paraprake - DKR	0	0	0	0	0
Penale shkalla e parë - DKR +	0	0	0	0	0
Penale për të mitur në proc.përgaditore	0	0	0	0	0
Penale për të mitur në proc.Para Kolegjit +	0	0	0	0	0
Civile të shkallës së I-rë +	1563	242	1805	139	1666
Jashtëkontestimore	232	9	241	44	197
Përmbarimore +	1177	59	1236	38	1198
Përmbarime sipas dokumenteve autentike	624	0	624	0	624
Përmbarime sipas dokumentit përmbarues	41	0	41	0	41
Ekz.Paushalla dhe shpenzime gjyqësore	812	98	910	111	799
Përmbarimore PPP Ekz	137	9	146	7	139
Ekz.Penale me burg	28	1	29	3	26
Ekz. Penale me gjobë- EDGJ	107	36	143	41	102
Ekz.i masave edukative për të mitur	0	0	0	0	0
UGJK	0	0	0	0	0
GJITHËSEJT	5634	533	6167	488	5679
Lëmia Kundërvajtëse	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuar-2024	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Lëmia- Kundërvajtëse	938	180	1118	155	963
GJITHËSEJT	938	180	1118	155	963

Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpcë

Të dhënat për lëndët e trashëguara, të pranuar, në punë, të kryera dhe lëndët e pa kryera për tremujorin e parë të vitit 2024 (1 janar deri më 31 mars 2024) për Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpcë.

Lloji i lëndëve	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuar-2024	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Procedura Paraprake - DP	3	3	6	4	2
Penale shkalla e parë- DP	110	19	129	55	74
Procedurë Paraprake - DKR	0	0	0	0	0
Penale shkalla e parë - DKR	0	0	0	0	0
Penale për të mitur në proc.përgaditore	0	0	0	0	0
Penale për të mitur në proc.Para Kolegjit	0	0	0	0	0
Civile të shkallës së I-rë	301	150	451	48	403
Jashtëkontestimore	25	4	29	2	27
Përmbarimore	219	10	229	12	217
Përmbarime sipas dokumenteve autentike	0	0	0	0	0
Përmbarime sipas dokumentit përmbarues	0	0	0	0	0
Ekz.Paushalla dhe shpenzime gjyqësore	105	17	122	9	113
Përmbarimore PPP Ekz	18	0	18	2	16
Ekz.Penale me burg	3	2	5	4	1
Ekz. Penale me gjobë- EDGJ	12	7	19	9	10
Ekz.i masave edukative për të mitur	0	0	0	0	0
UGJK	0	0	0	0	0
GJITHËSEJT	796	212	1008	145	863
Lëmia Kundërvajtëse	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuar-2024	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Lëmia- Kundërvajtëse	55	35	90	32	58
GJITHËSEJT	55	35	90	32	58

Nga gjyqtarët kërkohet që mos lejojnë shtyrje të panevojshme të seancave. Ngase kërkesat për shtyrjen apo për prova të reja nga palët ndonjëherë në thelb mund të mos kenë qëllimin legjitim, por mund të jenë të pajustificueshme dhe të kenë për qëllim vetëm prolongimin e proceseve.

Në përfundim konsiderojmë se me planin e rishpërndarjes së lëndëve numri i lëndëve të kontratave kolektive do të bie këto lëndë do të përfundohen në kohë të arsyeshme, dhe për këto arsye në takime me gjyqtar të divizionit civil gjithashtu edhe me gjyqtarët e Divizionit Penal të angazhuar në planin e rishpërndarjes është kërkuar që të angazhohen me tepër në trajtimin e lëndëve në këtë divizion duke u angazhuar edhe ndihma e bashkëpunëtorëve profesional, të cilët janë të angazhuar në shqyrtimin paraprak të këtyre lëndëve.

Gjykata Themelore në Ferizaj ka nevojë për plotësimin e pozitave të lira të pa plotësuara të gjyqtarëve dhe gjykata jonë të jetë në fokus tani në ndarjen dhe plotësimin e pozitave për gjyqtar sipas numrit të planifikuar të pozitave që i takojnë. Po ashtu gjykata dhe degët e saj kanë nevojë urgjente për plotësimin e pozitave të stafit administrativ (zyrtarë ligjore, arkivistë, shofer, shpërndarës të postës etj) pasi që vetëm në këtë tre mujor të parë katër punëtorë të kësaj gjykate kanë hequr dorë nga puna, disa për arsye personale disa janë avancuar në pozita institucione të ndryshme. Mungesa e stafit theksohet në degën e gjykatës në Kaçanik, ku kohëve të fundit jemi duke e përkrahur dhe mbështetur me staf nga gjykata jonë dhe dega në Shtërpçë për shkak të zyrtarëve të cilët janë në mungesë.

Megjithatë qasja jonë është që edhe në këto kushte edhe kapacitete që kemi me gjyqtarët aktual por edhe staf mbështetës administrativ, pavarësisht ngarkesës së rritur, duhet të bëjnë më shumë dhe të jenë më kërkuar në drejtim të shpejtësisë së gjykimit, rritjen e performancës dhe rrjedhimisht arritjes së rezultateve më të larta në punë, me qëllim që në vazhdimësi me kohë të trajtohen lëndët dhe kërkesat e ndryshme të qytetarëve-palëve, të cilët i drejtohen Gjykatës Themelore në Ferizaj.


Mustaf TAHIRI
Kryetar i Gjykatës Themelore në Ferizaj

Gjykata Themelore

Ferizaj

Sipas referencës:

GjA. nr. 142/24

Të datës: 05.04.2024

KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

R A P O R T

për punët e kryera

Periudhat raportuese

Të vitit	Kohët e vitit	
2024	Çereku I.	2024
	Çereku II.	
	Çereku III.	
	Çereku IV.	
Tërësisht për vitin		

I. Nga menaxhimi i përgjithshëm:

1.

1. Juridiksioni i gjykatës	Është gjykatë themelore e rajonit të		Ferizaj		me Komunitat rrethuese									
	Kjo gjykatë themelore		Sipas degëve të veta, të cilat											
	Funksionon në qytetin e:	Vendos sipas departamenteve:	Funksionojnë në:		Vendosin sipas departamentit nr.5:									
Ferizajt	1. Krime të rënda	2. Për të mitur	Penal	1	Kaçanik	5. I përgjithshëm sipas divizioneve:	Penal							
								3. I përgjithshëm sipas divizioneve:	Civil	2	Shtërpçë	Civil		
	Kundervajtje	3												Kundervajtje
	Ekzekutime	4												Ekzekutime

Komenti:

2.

2. Numri dhe struktura e të punësuarve

2.1 Numri i gjyqtarëve sipas angazhimit në punë, paraqitur strukturën gjinore dhe përkatësinë nacionale:

Gjykata themelore + Degët e gjykatës														Aprovuara		34		Plotësuara		31		Lira		3			
Shqiptar		Serb		Boshnjak		Turq		Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej													
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F												
19	9	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	19	12												
28		3		0		0		0		0		0		31													
Gjykata themelore														Ferizaj		Aprovuara		25		Plotësuara		22		Lira		3	
Shqiptar		Serb		Boshnjak		Turq		Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej													
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F												
14	7	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	14	7												
0		0		0		0		0		0		0		21													
Dega gjyqësore në														Kaçanik		Aprovuara		5		Plotësuara		5		Lira		0	
Shqiptar		Serb		Boshnjak		Turq		Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej													
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F												
3	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	2												
5		0		0		0		0		0		0		5													
Dega gjyqësore në														Shtërpcë		Aprovuara		4		Plotësuara		4		Lira		0	
Shqiptar		Serb		Boshnjak		Turq		Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej													
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F												
1			3											1	3												
1		3		0		0		0		0		0		4													
Dega gjyqësore në														Ferizaj		Aprovuara				Plotësuara				Lira		0	
Shqiptar		Serb		Boshnjak		Turq		Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej													
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F												
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0												
0		0		0		0		0		0		0		0													
Dega gjyqësore në																Aprovuara				Plotësuara		0		Lira		0	
Shqiptar		Serb		Boshnjak		Turq		Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej													
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F												
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0												
0		0		0		0		0		0		0		0													

2.2 Numri i stafit ndihmës të angazhuar në punë, paraqitur strukturën gjinore dhe përkatësinë nacionale:

Gjykata themelore + Degët e gjykatës														Aprovuara		0		Plotësuara		0		Lira		0			
Shqiptar		Serb		Boshnjak		Turq		Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej													
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F												
65	49	8	9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	73	58												
114		17		0		0		0		0		0		131													
Gjykata themelore														Ferizaj		Aprovuara				Plotësuara				Lira		0	
Shqiptar		Serb		Boshnjak		Turq		Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej													
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F												
47	39	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	47	39												
86		0		0		0		0		0		0		86													
Dega gjyqësore në														Kacanik		Aprovuara				Plotësuara				Lira		0	
Shqiptar		Serb		Boshnjak		Turq		Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej													

2. Numri dhe struktura e të punësuarve

M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F			
12	9			0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	12	9			
21		0		0		0		0		0		0		21				
Dega gjyqësore në				Shterpce				Aprovuara				Plotësuara				Lira		0
Shqiptar		Serb		Boshnjak		Turq		Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej				
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	
6	1	8	9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	14	10			
7		17		0		0		0		0		0		24				
Dega gjyqësore në				Aprovuara				Plotësuara				0	Lira		0			
Shqiptar		Serb		Boshnjak		Turq		Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej				
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
0		0		0		0		0		0		0		0				
Dega gjyqësore në				Aprovuara				Plotësuara				0	Lira		0			
Shqiptar		Serb		Boshnjak		Turq		Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej				
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
0		0		0		0		0		0		0		0				
Komenti:		pozitat e lira për gjyqtar të aprovuara nga KGJK të kenë prioritet në plotësimin e tyre, poashtu pozitat e lira të stafit administrativ dhe teknik plotësimi i tyre të jetë urgjente sepse mos plotësimi i këtyre pozitave ndikon në performancën dhe efikasitetin në punën e gjykatës në																

3.

2. Gjendja aktuale me aktivitete të burimeve njerezore

Nga Gjykatat themelore + Degët e gjykatës							
1. Shfrytëzimi i pushimeve							
Për të punësuarit në Gjykatë	Me pagesë				Pa pagesë		
	Vjetor	Mjekësor	Lehonie	Përdëllimit	Ngritje profesionale	Kujdes familjar	Tjetër
Gjyqtar	11	3					
Nëpunës	57	49	4	3			
Total:	68	52	4	3	0	0	0
Komenti:	do të ishte mirë që të jetësohej ideja e shfrytëzimeve të pushimit vjetor si nga gjyqtarët po ashtu edhe nga administrata e saj në bllok për një periudhë të caktuar. Shfrytëzimi i pushimeve vjetor në praktikën siç është tani për tani me këtë numër të madh të punësuarve është jo i duhur. po ashtu edhe shfrytëzimi i pushimeve mjekësore të jetë racional vetëm atëher kur njëmend është nevoja për pushim mjekësor. e mos të kalohet në shfrytëzim dhe						
Për të punësuarit në Gjykatë	Te shpallura:			Lloji i kontrates		Rezultati i konkurseve	
	Konkurse te jashtme	Konkurse te brendshme	Nr. i kandidateve konkures	Karrieres / Jo karrieres	Punes	Pozitiv	Negativ
Gjyqtar							
Nëpunës							
Total:	0	0	0	0	0	0	0
Komenti:							
3. Disiplinimi:							
Për të punësuarit në Gjykatë	Disiplinimi	Komisioni i brendshem		Shkalla e dyte		Lloji i masës	
	Numri i Disiplinimeve	Disiplinuar	Liruar	Disiplinuar	Liruar	Mase e lehte disiplinore	Mase e rende disiplinore
Gjyqtar							

Nëpunës	1	1				1	
Total:	1	1	0	0	0	1	0
Komenti:	Një punëtorë roje sigurimi me datën 13.03.2024 me vendim të drjtorit të SKGJK është pezulluar nga puna dhe është inicuar procedura disiplinore.						
4. Ankesat në përgjithësi:							
Për të punësuarit në Gjykatë	Ankimimet			Komisioni i brendshëm		Shkalla e dyte	
	Numri i ankesave	Ankese per rekrutim	Ankese tjeter	Miratuar	Refuzuar	Miratuar	Refuzuar
Gjyqtar	2				2		
Nëpunës							
Total:	2	0	0	0	2	0	0
Komenti:							

4.

Nga Gjykatat themelore + Degët e gjykatës

1. Për programin e buxhetuar të gjykatës për vitin 2024, shprehur në Euro valutë:

Periudha:	Destinacioni i parasë:		Të buxhetuara:	Të shpenzuara:	Të pa shpenzuara:
Çereku: I./2024	a.	Paga dhe mëditje			- €
	b.	Mallra dhe shërbime	215,700.00 €	31,080.21 €	184,619.79 €
	c.	Shpenzime komunale	48,000.00 €	8,735.96 €	39,264.04 €
	d.	Investime kapitale			- €
	Në përgjithësi:		263,700.00 €	39,816.17 €	223,883.83 €
Komenti:					
Periudha:	Destinacioni i parasë:		Të buxhetuara:	Të shpenzuara:	Të pa shpenzuara:
Çereku: II./2024	a.	Paga dhe mëditje	- €	- €	- €
	b.	Mallra dhe shërbime	215,700.00 €	- €	215,700.00 €
	c.	Shpenzime komunale	48,000.00 €	- €	48,000.00 €
	d.	Investime kapitale	- €	- €	- €
	Në përgjithësi:		263,700.00 €	- €	263,700.00 €
Komenti:					
Periudha:	Destinacioni i parasë:		Të buxhetuara:	Të shpenzuara:	Të pa shpenzuara:
Çereku: III./2024	a.	Paga dhe mëditje	- €	- €	- €
	b.	Mallra dhe shërbime	215,700.00 €	- €	215,700.00 €
	c.	Shpenzime komunale	48,000.00 €	- €	48,000.00 €
	d.	Investime kapitale	- €	- €	- €
	Në përgjithësi:		263,700.00 €	- €	263,700.00 €
Komenti:					
Periudha:	Destinacioni i parasë:		Të buxhetuara:	Të shpenzuara:	Të pa shpenzuara:
Çereku: IV./2024	a.	Paga dhe mëditje	- €	- €	- €
	b.	Mallra dhe shërbime	215,700.00 €	- €	215,700.00 €
	c.	Shpenzime komunale	48,000.00 €	- €	48,000.00 €
	d.	Investime kapitale	- €	- €	- €
	Në përgjithësi:		263,700.00 €	- €	263,700.00 €

4. Hyrje/daljet
financiare

Komenti:						
Nga Gjykatat themelore + Degët e gjykatës						
2.1. Të hyrat në buxhetin e Kosovës						
Nga periudhat:	Të inkasuara në Euro valutë, sipas bazës paguese					Gjithësej
	Taksë	Dënim	Paushall	Shpenzim	Konfiskim	
I./2024	92,027.16 €	170,985.00 €		- €	- €	263,012.16 €
II./2024	- €	- €	- €	- €	- €	- €
III./2024	- €	- €	- €	- €	- €	- €
IV./2024	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Gjithësej:	92,027.16 €	170,985.00 €	- €	- €	- €	263,012.16 €
Komenti:						
Nga Gjykatat themelore + Degët e gjykatës						
2.2. Për të hyrat në Thesarin (Trezorin) e Kosovës						
Nga periudhat:	Të inkasuara në Euro valutë, sipas bazës paguese					Gjithësej
	Garancion për kontest	Depozitim (pignus) gjyqësor	Corpus delicta	Parapagim për shpenzime	Për raste tjera	
I./2024	- €	17,526.80 €	- €	- €	- €	17,526.80 €
II./2024	- €	- €	- €	- €	- €	- €
III./2024	- €	- €	- €	- €	- €	- €
IV./2024	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Gjithësej:	- €	17,526.80 €	- €	- €	- €	17,526.80 €
Komenti:						

5.

5. Çështje Logjistike

Divizioni për logjistikë në GJTH-Ferizaj, më kapacitetet që disponon dhe me një menaxhim të suksesshëm ka arrite të i përmbushë objektivat e përcaktuara në fillim të vitit , nuk ka ardhë deri te dështimi i seancave si pasoj e mos angazhimit të dorëzuesve. Po theksojmë se për muajin. I-II-III/2024, Automjetet e Gjykatës Themelore në Ferizaj me degë gjatë kësaj periudhe kanë kaluar 26303.Km, dhe kanë hargjuar 1589/Litra karburante ose shprehur në hargjime në 100 km ,6.04 litra .- Është bërë përpjekje maksimale për kujdesin e mirë mbajtjes së objektit me theks të veçant në mbajtjen e higjienës. - Divizioni për logjistikë gjatë punës nuk ka pasë probleme dhe ngecje, është përkujdesë që furnizimi me material të jetë në nivel dhe mos të ketë pengesa gjat procesit të punës.

6.

6. Prokurimi Publik	Numri i prokurimit publik	Lloji i kërkesës	Shuma	Realizimi	
				po	jo
			- €	0	0
			- €	0	0
			- €	0	0
			- €	0	0
			- €	0	0
E përgjithshme prej: 01.01.2024-31.12.2024			- €	0	0

7.

7. Projektet e realizuara	1. Numri i projektit	
	2. Emërtimi i projektit:	
	3. Partenerët e projektit:	
	4. Vlera e projektit:	
	5. Të involvuarit në projekt:	
	6. Kostoja e projektit:	
	7. Rezultatet e projektit:	
	Komenti:	

8.

8. Identifikimi i pengesave në punët për vendimarrje lidhur me paqartësi ligjore në zbatim

Si pengesë në punë nga Gjykata Themelore në Ferizaj, paraqesim sistemin SMIL i cili kohëve të fundit ka pasur pengesa në punë. Këto pengesa janë paraqitur nga rrjeti i dobët i internetit i cili ka ndikuar edhe në punën dhe funksionimin e sistemit SMIL. Operatori i ri për mirmbajtjen e printerave - skanerave dhe fotokopjuesve është ndrruar dhe tani kemi një operator të ri, i cili nuk është duke ju përgjigjur fare kërkesave të gjykatës për furnizim me printer-toner dhe skaner. kemi mungesë të madhe të tonerave, prishje dhe defekte të printerave dhe skanerave dhe nuk kemi në dispozicion servis për rregullimin e tyre. duke pasur parasysh që tani gjithqka është e digjitalizuar dhe nevojitet shtimi i skanerëve dhe printerëve pasi që nëse vazhdohet me këtë injorim nga kompania dhe mospërgjigje në kërkesat të gjykatës do të kemi probleme serioze në përmbushjen e detyrave dhe punëve të gjykatës. Mungesa e zyrtarëve dhe stafit sidomos zyrtarëve ligjor, një zyrtari të arhivës, dorëzuesve dhe zyrtarëve të sigurimit dhe po ashtu

9.

9. Mbledhjet e mbajtura lidhur me menaxhimin e gjykatës dhe lëndëve gjyqësore

Me qëllim të menaxhimit dhe efikasitetit në punë të Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe Degët e saja Kaçanik dhe Shterpcë, Kryetari i Gjykatës ka mbajtur takime të rregullta me mbikqyrësit e Degëve si dhe gjyqtarët e kësaj Gjykate takimi vjetor i mbajtur me të gjithë gjyqtarët e Gjykatës si dhe ata të Degeve i dates 12.01.2024, Takimi i dates 24.01.2024 me të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Themelore në Ferizaj ashtu edhe të Degëve, Takimi i datës 30.01.2024, me gjyqtarët e Departamentit të Përgjithshëm Divizioni Civil, Takimi i datës 09.02.2024, i mbajtur me gjyqtarët e Departamentit të Përgjithshëm Divizioni Penal, Takimi i datës 22.02.2024, i mbajtur me Udhëheqësit e Departamenteve, Takimi i datës 28.02.2024 i mbajtur me gjyqtarët e Gjykatës Themelore në Ferizaj, takimi i datës 22.03.2024, i mbajtur nga Nënkryetarja e Gjykatës me gjyqtarët e Departamentit të Përgjithshëm Divizioni Civil, Takimi i datës 25.03.2024, me gjyqtarët e Departamentit për Krime të Rënda.

10.

10. Identifikimi i pengesave në punë dhe propozimi i masave për tejkalimin e tyre

në rubrikat e mësipërme si pengesa të identifikuar u paraqiten mungesa dhe plotësimi i pozitave të lira të stafit administrativ dhe teknik. gjatë kësaj periudhe raportuese në Gjykatën Themelore Ferizaj kemi katër punëtor që kanë dhënë dorëheqje dhe mungesa e tyre vërehet në mënyrë të theksuar, andaj si propozim për tejkalimin e këtyre pengesave mbetet plotësimi i pozitave të lira.

11. Bashkëpunimi i gjykatës me subjektët jo gjyqësor kombëtar dhe ndërkombëtar.

Gjykata Themelore në Ferizaj edhe në këtë tre muor të I-të, ka vazhduar bashkëpunimin me përfaqësues të Institucioneve tjera, duke dhënë kontributin e saj në këto takime. Takime të rregullta me Prokurorinë Themelore në Ferizaj, Policinë e Kosovës Qendra për punë Sociale, Oda e avokateve të Kosovës Ferizaj si dhe USAID. Në Gjykatën Themelore në Ferizaj, vazhdon implementimin e projektit, Planit të veprimit të projektit për drejtësi Procedurale.

12. E rëndësishme veçantë për paraqitje në KGJK

Edhe për këto vite ne si gjykate, paraqesim gjendjen e arkives me të cilën përballemi çdo ditë, kjo për shkak se lëndët e arkivuara nuk mund të mirren prej saj sepse të njejtat gjenden në podrumin e gjykatës, dhe se podrumi nuk i ploteson kushtet e arkivës. Ne kemi angazhuar zyrtarin e arkivës nga Dega e Shtërpcës kjo për shkak se zyrtarja e Arkivës në Ferizaj për shkak të problemeve mjekësore, e njejtat nuk mund ti përgjigjet vendit të saj të punës nga kundërmimi që është në arkivë.

II. Treguesit statistikor për lëndët gjyqësore:

III. Përmbyllja

1

Rekomandime për KGJK

2

Përfundim
përmbledhës

Periudha e tremujorit të I-rë 2024, ka qenë periudhë e suksesshme në aspektin e ngritjes së efikasitetit të përfundimit të lëndëve. Çështje penale të arritura gjatë kësaj periudhe përfshirë degët kanë qenë 358 , ndërsa janë përfunduar 482 lëndë apo shprehur në përqindje normës e efikasitetit është mbi 134.64%. Lëndë penale në Departamentin për Krime të Renda, janë pranuar 15, ndërsa janë përfunduar 36, norma e spastrimit është 240.00%. Te rastet civile gjatë kësaj periudhe (së bashku me degë) janë pranuar 1874 lënd, ndërsa janë përfunduar 1464 lëndë , norma e spastrimit është 78.12%. Ndërsa lënd në Divizionin për Kundërvajtje janë pranuar 842, ndërsa janë përfunduar 722 apo mbi 85.75%.



Kryetari i gjykatës
MUSTAF TAHIRI

(nënshkrimi)